



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:021987

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05717426

2022:021988

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, me NUI, kundër të paditurit I.L.A. nga Ferizaj, rr. ..., pn, me nr. personal ..., me objekt kontesti kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 219,43 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË / MOSBINDJES

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri I.L.A. nga Ferizaj, që t'ia paguaj paditësit dëmin e shkaktuar material në shumë prej 219,43 euro (dyqind e nëntëmbëdhjetë euro e katërdhjetë e tre cent), dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë nga data 04.02.2022 e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. DETYROHET i padituri I.L.A. nga Ferizaj, që t'ia paguaj paditësit KEDS me seli në Prishtinë shpenzimet procedurale për pagesën e taksës për padi në shumën prej 20,00€ (njëzetë), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi më datë 04.02.2022, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit për kompensimin e dëmit material, me vlerë të kontestit prej 219,43 euro, duke theksuar se sipas aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.1887/17 të datës 14.11.2017, i cili ka marrë formën e prerë më datë 29.12.2017, i padituri është shpallë fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale “**Lidhja e paautorizuar në shërbime**” nga neni 321 të KPRK, përderisa i dëmtuari, tani paditësi është udhëzuar në kontest civil për kompensimin e dëmit të shkaktuar në lidhje me veprën e lartpërmendur penale. Ka shtuar se me veprimet e të paditurit, duke bërë lidhjen direkte në rrjetin elektrik në mënyrë të paautorizuar, paditësit i është shkaktuar dëm material që arrin vlerën totale prej 219,43 euro. Nga këto arsye, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurin që t’ia paguajë dëmin material në shumën prej 219,43 euro, si dispozitiv të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi C.nr.2022:021988, të dt. 26.01.2024, të cilin i padituri së bashku me shkresat e lëndës e ka pranuar me datë 05.02.2024, fakt të cilin gjykata e konfirmoi nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës e datës 05.02.2024. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t’i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me shkresate lëndës në këtë çështje juridike kontestimore, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ke gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150, paragrafi 1, pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, se të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Gjykata nga provat që i janë bashkëngjitur padisë ka vërtetuar faktin se i padituri është shpallë fajtor me vendim të formës së prerë (aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal P.nr.1887/17 të datës 14.11.2017, i cili ka marrë

formën e prerë më datë 29.12.2017) dhe se me veprimet e tij ka dëmtuar paditësin në shumën prej 219,43 euro (kalkulimi i rikthimit të humbjeve sipas shifrës së konsumatorit DFE 9019886 dhe fatura ..., e datës 27.04.2017), andaj vlerësoi se paditësi ka argumentuar përgjegjësinë e të paditurit në shkaktimin e këtij dëmi përmes aktgjykimit penal (bazën juridike) dhe vlerën e dëmit të shkaktuar përmes kalkulimit të rikthimit të humbjeve dhe faturës (lartësinë e kërkesëpadisë).

Vlen të ceket se në kuptim të nenit 14 të LPK, në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor. Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (LMD), edhe atë nenit 8 i cili përcakton “Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktoj dëm tjetrit”; nenit 136, paragrafi 1 se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”; nenit 137 se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”; nenit 140 se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”; si dhe nenit 169, paragrafi 1 se “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”.

Meqë i padituri ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me shkresat e lëndës dhe nuk ka kthyer përgjigjen në padi, ndërsa faktet e treguara në padi mbështeten në provat e theksuara si më lartë dhe kërkesa është e themeltë bazuar dispozitave ligjore të LMD-së, gjykata vendosi që të nxjerrë aktgjykim pa konvokuar shqyrtim gjyqësor, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak të plotësisë së kushteve të parapara në nenin 150 të LPK-së.

Sa i përket kamatës, gjykata u bazua në nenin 382 të LMD-së.

Për shpenzimet e procedurës gjykata, ka vendosur në bazë të nenit 452, paragrafi 1 dhe 463, paragrafi 1 të LPK-së, pasi që paditësi e ka fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet.

Nga të lartëcekurat dhe bazuar në nenin 150 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

2022:021988, datë 22.05.2024

Gjyqtari,

Armend Ahmeti

Udhëzimi mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimet të tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.

Në kuptim të nenit 491.1 të LPK, aktgjykimi ose aktvendimi me të cilin përfundohet procedura e zgjidhjes së kontestit me vlerë të vogël mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.